


Nr. 6491 Prot

Elbasan më 18.12.2025

Buxheti 2026



Bashkia Elbasan



Relacion Për Këshilltarët


VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM		3
KAPITULLI -1	TË ARDHURAT BUXHETORE 2026	4
KAPITULLI -2	TË ARDHURAT VENDORE TË BASHKISË ELBASAN 2026	10
KAPITULLI -3	TRANSFERTAT NGA BUXHETI I SHTETIT 2026	27
KAPITULLI -4	PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 2026	31
KAPITULLI -5	SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK	38

KAPITULLI 1

Vështrim i përgjithshëm:

Bashkia Elbasan tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe prej 872km² dhe një popullsi prej rreth 208,480 banorë të regjistruar. Bashkia Elbasan perbehet nga 12 Njësi Administrative: LabinotFushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Papër dhe qyteti i Elbasanit.

BASHKIA ELBASAN TERRITORI ADMINISTRATIV



Bashkia Elbasan Kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Librazhd, në jug-lindje me bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin. Bashkia e Elbasanit është një nga më të mëdhatë në Shqipëri, ka nën administrimin e saj qytetin e Elbasanit dhe 116 fshatra.

Hartimi i Programit Buxhetor i Bashkisë Elbasan për vitin 2026, mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Në bazë të funksioneve të pushtetit vendor të përcaktuara në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV".

Dokumenti i Buxhetit paraqet me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet sipas programeve buxhetore. Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga njësitë shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse.

Projekt buxheti bazohet në parashikimet e Bashkisë Elbasan për vitin 2026 në mënyrë që të sjellë të integruar informacionin financiar për të ardhurat dhe shpenzimet me informacionin për dokumentat strategjike dhe investimet kapitale për tu zbatuar me qëllim të përmbushjes së vizionit dhe objektivave strategjike.

Për të realizuar përpjekjet për një qytet më modern, me shërbime publike me cilësore, me një zhvillim ekonomik më dinamik, me mundësi të shumta për të rinjtë, me një jetë kulturore më të zhvilluar, me shkolla më të rinovuara për fëmijët, me hapësira të dedikuara për çiklistët etj.

Prioritete këto që janë gjithashtu shprehje e kërkesave të qytetarëve, nëpërmjet bashkëbisedimeve në të gjitha Njësitë Administrative si dhe në diskutimet publike gjatë procesit të buxhtimit me pjesëmarrje.

KAPITULLI 2

TE ARDHURAT BUXHETORE 2026

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë Elbasan, përbëhen nga:

I. Të ardhurat e veta:


- a) Të ardhurat nga taksat vendore
- b) Të ardhurat nga taksat e ndara
- c) Të ardhurat nga tarifat
- ç) Të ardhurat jo-tatimore
- d) Të ardhurat nga institucionet e varësisë
- e) Të ardhurat nga funksionet specifike

II. Transferta e pakushtëzuar.

III. Transferta e pakushtëzuar sektoriale.

IV. Huamarrja e qeverisjes vendore.

Paraqitja grafike e të dhënave:



Për vitin 2026 është llogaritur që të ardhurat nga taksat e ndara të arrijnë në shumën **182,600 mijë lekë** me një rritje prej **13%** në krahasim me parashikimin e vitit 2025, që shprehur në vlerë monetare është **21,200 mijë lekë** më shumë.

Për vitin 2026 është llogaritur që të ardhurat nga taksat vendore të arrijnë në shumën **569,700 mijë lekë**, me një rritje prej **12%** në krahasim me parashikimin e vitit 2025, që shprehur në vlerë monetare është **63,050 mijë lekë** më shumë.

Për vitin 2026 është llogaritur që të ardhurat nga tarifat të arrijnë në shumën **722,246 mijë lekë** me një rritje prej **44%** në krahasim me parashikimin e vitit 2025, që shprehur në vlerë monetare është **219,206 mijë lekë** më shumë.

Për vitin 2026 është llogaritur që të ardhurat jo-tatimore të arrijnë në shumën **161,968 mijë lekë**, me një ulje prej 9% në krahasim me parashikimin e vitit 2025, që shprehur në vlerë monetare është **15,462 mijë lekë** më pak.

Për vitin 2026 është llogaritur që të ardhurat nga institucionet e varësisë të arrijnë në shumën **80,653 mijë lekë**, me një rritje prej 5% në krahasim me parashikimin e vitit 2025, që shprehur në vlerë monetare është **3,821 mijë lekë** më shumë.

Për vitin 2026 është llogaritur që të ardhurat nga funksionet specifike të arrijnë në shumën **75,015 mijë lekë**, me një rritje prej 2.5% në krahasim me parashikimin e vitit 2025, që shprehur në vlerë monetare është **1,815 mijë lekë** më shumë.

Për vitin 2026, vlera e transfertës së pakushtëzuar akorduar për Bashkinë Elbasan është në shumën **1,239,785 mijë lekë** ose 8% më e lartë se transfertat e pakushtëzuar për vitin 2025, që shprehur në vlerë monetare është **92,031 mijë lekë** më shumë.

Për vitin 2026, vlera e transfertës së specifike akorduar për Bashkinë Elbasan është në shumën **762,129 mijë lekë** ose 16% më e lartë se transfertat e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2025, që shprehur në vlerë monetare është **106,329 mijë lekë** më shumë.


Në vija të përgjithshme parashikimi i të ardhurave për vitin 2026, paraqitet me këto vlera në 000/mijë lekë:

PLAN VJETOR 2026		000 leke
TE ARDHURA		2026
A	Trasheguar nga v.2025	135,227
	Trasheguar grant dhe te ardhura 2025	118,000
	Trasheguar grant specifik 2025	17,227
B	TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V+VI)	1,792,182
I	TE ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	569,700
1	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	1,500
2	Taksa mbi ndertesat	289,000
3	Taksa mbi token bujqesore	27,100
4	Taksa mbi truallin	35,000
5	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	10,000
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	200,000
7	Taksa e tabelës	7,100
II	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	182,600
1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise	7,000
2	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	94,800
3	Taksa e rentes minerare	800
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	80,000

III	TE ARDHURA NGA TARIFAT	722,246
1	Tarife per zenien e hapësirës publike	32,000
2	" pastrimi	280,000
3	" gjelberimi	70,000
4	" ndricimi	120,000
5	" mirembajtje infrastrukture ne Nj.Admin.	11,400
6	" reklame	4,800
7	" parkim automjete	98,728
8	" embleme bashkie	68
9	" leje, certificate transporti	1,500
10	" autorizim treg. karburanti + lende djegese	10,000
11	" leshimin e vertetimeve	2,130
12	" autoriz., zgjatje orari ,etj	3,700
13	" sherbimi karrotresh	300
14	" leje perdorimi per objekte biznesi	1,500
15	" leje perdorimi per banim	2,000
16	" certifikim relievi	2,300
17	" deklarim paraparak	800
18	" trajt.fasades ndertesave	3,000
19	" aplikim leje zhvillimi	500
20	" hartim PDV per siperfaqen e prones	2,000
21	" shqyrtim dokumenta leje ndertimi	2,900
22	" kantier ndertimi brenda prones	7,000
23	" depozitimi i mbetjeve te ngurta	15,000
24	" leshimin e dok.nga arkiva	100
25	" rrjetin e tubacion.ujrave bardha	2,200
26	" rrjetin e tubacion.ujrave zeza	300
27	" sherbimi per rrjetin kabllor	6,000
28	" uji pijshem	20
29	" per mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit	42,000
IV	TE ARDHURA JO-TATIMORE	161,968
1	Qera objekti	450
2	Qera trualli	4,208
3	Qera toke bujqesore	310
3	Gjoha ndertimi	50,000
5	Gjoha biznesi	12,000
6	Gjoha policia bashkiake	5,000
7	Te ardhura nga legalizimet	45,000
8	Te ardhura nga shitja e asetëve (FK)	45,000
V	TE ARDHURA INSTITUCIONET	80,653
1	Dr.Pergj. Arsimit Parashkollor	58,537
	Te ardhura nga Cerdhet	14,714
	Te ardhura nga kopeshtet	35,622

	Te ardhura nga qerate	8,201
2	Klubi Shumesporte	1,346
	Te ardhura nga qira objekti	1,246
	Te ardhura okupim salle	100
3	Teatri "Skampa"	1,100
	Te ardhura nga biletat	1,000
	Te ardhura okupim salle	100
4	Trashegimia Kulturore dhe Turizmi	70
	Te ardhura Trashegimia Kulturore	50
	Te ardhura bileta Info Point	20
5	Agjensia e Sherbimeve Publike Rurale	0
	Te ardhura nga qira mjetesh	0
5	Agjensia e Sherbimeve Publike Urbane	12,100
	Te ardhura sherbimet publike	100
	Te ardhura M.Varreza	10,000
	Tarife sherbimi per subjektet qe kryejne punime per riparimin e varreve	2,000
6	Te ardhura nga Banesat Sociale	7,500
	Te ardhura nga qirate	7,500
VI	TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE	75,015
1	Te ardhura nga Zjarrfikesja	2,200
2	Te ardhura nga Sherbimi Pyjor	65,565
	Te ardhura nga vertetime, etj.	530
	Tarife per lende drusore	33,509
	Qera per pyje dhe kullota	31,526
3	Te ardhura Ujitja dhe Kullimi	7,250
C	TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR (grant)	1,239,785
	Trasferte e pakushtezuar e pergjithshme	1,058,392
	Rritja e nivelit te pagave	181,393
D	TRANSFERTA SPECIFIKE (grant)	762,129
	Konviktet e arsimit parauniversitar	32,357
	Arsimi parashkollor, personeli mesimor	367,044
	Arsimi parashkollor, stafi mbeshtetes	94,706
	Arsimi parauniversitar	52,828
	Mbrojtja nga zjarri	75,464
	Mbrojtja sociale	24,011
	Administrimi I pyjeve	17,923
	Rruget rurale	22,976
	Ujitja dhe kullimi	18,820
	Menaxhimi I mbetjeve urbane	56,000
E	Te ardhura nga huamarrja 2026	83,778
	TOTAL TE ARDHURA :	4,013,100

Raporti i burimeve të financimit:



Burimet e financimit të Buxhetit 2026

Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026 ka një total të parashikuar të ardhurash prej **4,013,100 mijë lekësh**. Ky buxhet pasqyron një strukturë të mirëbalancuar të burimeve financiare, të cilat sigurojnë stabilitet dhe mundësi për zhvillim të qëndrueshëm në nivel lokal.

Një pjesë e rëndësishme e të ardhurave janë **të ardhurat e trashëguara nga viti 2025**, në shumën prej **135,227 mijë lekësh**, që përbëjnë rreth 5% të totalit. Kjo shumë pasqyron fondet e mbetura nga vitet e mëparshme, të cilat do të përdoren për vijimin e projekteve në zbatim dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve.

Një peshë të konsiderueshme në financimin e buxhetit e zënë **të ardhurat nga burimet vendore**, të cilat kontribuojnë së bashku me rreth 36% të totalit:

- **Taksat vendore** pritet të sjellin **569,700 mijë lekë** ose **14%** të të ardhurave totale. Kjo përfshin taksat e vendosura nga bashkia, të cilat janë baza financiare për funksionimin e saj dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.
- **Taksat e ndara** kontribuojnë me **182,600 mijë lekë** (rreth **4%**), të ardhura këto që vijnë nga një pjesë e taksave kombëtare të ndara me pushtetin vendor, në kuadër të një sistemi të decentralizuar financiar.
- **Të ardhurat nga tarifat** janë një tjetër burim i rëndësishëm, me **722,246 mijë lekë**, që përbëjnë **18%** të totalit. Këtu përfshihen tarifat për shërbime të ndryshme publike që ofron bashkia, siç janë tarifat për licenca, shërbime administrative, dhe shfrytëzime të tjera.

Përveç këtyre, **të ardhurat jo-tatimore** arrijnë në **161,968 mijë lekë** (rreth **4%**), ndërsa të ardhurat nga institucionet nën varësi të bashkisë janë **80,653 mijë lekë** (rreth **2%**). Gjithashtu, të ardhurat nga funksionet specifike, që janë fondet e dedikuara për detyra dhe projekte të caktuara, shënojnë **75,015 mijë lekë**, ose **2%** të totalit.

Një rol kryesor në financimin e buxhetit e luajnë **transfertat nga buxheti qendror i shtetit**, të cilat përbëjnë më shumë se gjysmën e totalit të të ardhurave, duke siguruar mbështetje të rëndësishme për funksionimin dhe zhvillimin e bashkisë:

- **Transferta e pakushtëzuar (grant)** përbën shumën më të madhe, me **1,239,785 mijë lekë**, që përfaqëson rreth **31%** të të ardhurave totale. Këto fonde janë të destinuara për mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme të bashkisë dhe për të garantuar stabilitetin financiar.
- **Transferta specifike (grant)**, në vlerën **762,129 mijë lekë**, përbën një pjesë prej **19%** të buxhetit. Këto fonde janë të dedikuara për shërbime të caktuara, duke siguruar mbështetje të drejtpërdrejtë në fushat ku ka më shumë nevojë.

Së fundi, **të ardhurat nga huamarrja për vitin 2026** shënojnë **83,778 mijë lekë**, që përbëjnë **2%** të totalit të burimeve financiare. Kjo pjesë shfrytëzohet për të mbështetur investimet kapitale, duke rritur kapacitetet e bashkisë për zhvillim afatgjatë dhe përmirësim të infrastrukturës.

Në total, kjo strukturë financimi tregon një menaxhim të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm të burimeve, ku balancohet fuqishëm pjesëmarrja e të ardhurave vendore me mbështetjen e buxhetit qendror dhe përdorimin e strategjive të huamarrjes.

KAPITULLI -2

TË ARDHURAT VENDORE TË BASHKISË ELBASAN


TAKSA VENDORE

A) Taksa mbi ndërtesën

Taksa mbi ndërtesën është ndër burimet më të rëndësishme në buxhetin e Bashkisë Elbasan dhe përbën rreth **51%** të totalit të të ardhurave vendore.

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e detyrimit për këtë taksë nga subjektet që realizojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Elbasan, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ndërsa për detyrimet e kategorisë familjarë, është përzgjedhur si Agjent tatimor Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan dhe Njësitë Administrative. Për vitin 2026 parashikohet **289,000 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Emertimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Te ardhurat nga Taksa mbi ndërtesat	214,600	223,062	223,062	210,200	289,000

B) Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar nga bizneset e vogla, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Elbasan. Për vitin 2026 parashikohet **1,500 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:



Emertimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	6,000	3,000	2000	2000	1,500

C) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të aksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Për vitin 2026 parashikohet **27,100 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Emertimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa mbi tokën bujqësore	26,400	27,480	27,480	27,100	27,100

D) Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m2, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për vitin 2026 parashikohet **35,000 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa mbi truallin	27,000	36,840	36,840	31,350	35,000

E) Taksa për fjetjen në hotel

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi. Për vitin 2026 parashikohet **10,000 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa për fjetjen në hotel	7,000	8,500	9,000	9,000	10,000

Taksa për fjetjen në hotel	7,000	8,500	9000	9000	10,000
----------------------------	-------	-------	------	------	--------

F) Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Taksa ndikimit në infrastrukturë është taksa në masën sipas përcaktimeve ligjore që paguajnë subjektet kur pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera. Për vitin 2026 parashikohet **200,000 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	250,000	360,000	325,000	220,000	200,000

G) Taksa e tabelës

Vendosja e tabelës nga subjektet bëhet për qëllime identifikimi të veprimtarisë së biznesit. Masa e taksimit varet nga lloji i tabelës së vendosur, sipërfaqja që zë tabela, ruajtja dhe kategorizimi. Për tabelën për qëllime identifikimi, deri në 2 m², masa e taksës është zero. Për vitin 2026 taksa e tabelës parashikohet **7,100 mijë lekë**.

Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa e tabelës	750	1,300	1300	7,000	7,100

Paraqitja grafike e të dhënave:



TAKSAT E NDARA

A) Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë

Të dhënat për parashikimin e kësaj takse merren nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme. Mbledhja e kësaj takse realizohet nga strukturat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, agent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar. Për vitin 2026 parashikohet 7,000 mijë lekë.

Paraqitja grafike e të dhënave:



Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
-----------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

Taksa mbi kalimin e pronësisë	7,000	15,000	6,500	13,000	7,000
-------------------------------	-------	--------	-------	--------	-------

B) Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (D.R.SH.T.RR. Elbasan) gjatë kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për vitin 2026 parashikohet **94,800 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	70,000	70,000	79000	87,600	94,800

C) Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite. Për vitin 2026 taksa e rentës minerare parashikohet **800 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:


Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Renta minerare	2,000	500	900	800	800



D) Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Planifikimi i të ardhurave i është referuar të dhënave statistikore për të punësuarit në territorin e Bashkisë Elbasan, si dhe raporteve vjetore të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Për vitin 2026 Tatimi mbi të ardhurat personale parashikohet 80,000 mijë lekë.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Tatimi mbi të ardhurat personale	30,000	34,000	40,000	60,000	80,000

TARIFA VENDORE

- **Tarifa për zënien e hapësirës publike**

Tarifa për zënien e hapësirës publike llogaritet duke u bazuar në sipërfaqen që shfrytëzohet nga subjektet për ushtrimin e aktivitetit të sipas zonës dhe hapësirës në m². Për vitin 2026 taksa e hapësirës publike parashikohet **32,000 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Tarifë për zënien e hapësirës publike	38,000	32,500	30,000	30,000	32,000

- **Tarifa e pastrimit**

Tarifa e Pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit janë tarifa të cilat u ngarkohen të gjitha familjeve, personave fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Elbasan. Mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Elbasan për subjektet ekonomike dhe Ujësjiellës – Kanalizime Elbasan për kategorinë familjarë. Për vitin 2026 tarifat parashikohen:

Tarifa e pastrimit është një pagesë vendore që aplikohet për mbulimin e kostove të shërbimeve të pastrimit publik. Kjo tarifë përdoret për financimin e aktiviteteve që lidhen me grumbullimin, transportin dhe largimin e mbetjeve urbane, si dhe për pastrimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike. Qëllimi i kësaj tarife është garantimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për komunitetin. Për vitin 2026 tarifa e pastrimit parashikohet në **280,000mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Tarifa e pastrimit	185,000	185,000	186,000	204,950	280,000

- Tarifa e gjelberimit**

Tarifa e gjelbërimit shërben për financimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të hapësirave të gjelbra publike. Kjo përfshin mbjelljen e pemëve dhe bimësisë dekorative, mirëmbajtjen e parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbra, si dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit urban. Kjo tarifë synon rritjen e cilësisë së jetesës dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm ekologjik.

Për vitin 2026 tarifa e gjelbërimit parashikohet në 70,000 mijë lekë.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Tarifa e gjelberimit	45,000	34,000	39,000	49,000	70,000

- **Tarifa e ndriçimit publik**

Tarifa e ndriçimit publik është një pagesë vendore që përdoret për mbulimin e kostove të ndriçimit të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike. Ajo përfshin shpenzimet për energjinë elektrike, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit dhe zëvendësimin e pajisjeve ndriçuese. Qëllimi i kësaj tarife është garantimi i sigurisë publike, përmirësimi i qarkullimit dhe rritja e komoditetit të qytetarëve gjatë orëve të natës.

Për vitin 2026 tarifa e ndriçimit publik parashikohet në **120,000 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Tarifa e ndriçimit	81,000	65,000	65,000	79,100	120,000

Kategoritë tarifave që ndikojnë në planin e të ardhurave nga burimet e veta të parashikuara për vitin 2026 janë:

- Mirembajtje infrastrukture e cila për vitin 2026 parashikohet të jetë **11,400 mijë lekë**.
- Reklame e cila për vitin 2026 parashikohet të jetë **4,800 mijë lekë**.
- Parkim automjete e cila për vitin 2026 parashikohet të jetë **98,728 mijë lekë**.
- Leje, certificate transporti për vitin 2026 parashikohet të jetë **1,500 mijë lekë**.
- Autorizim treg. karburanti + lende djegese parashikohet **10,000 mijë lekë**.
- Ndotjes mjedisit për vitin 2026 parashikohet të jetë **42,000 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Mirembajtje infrastrukture	5,220	4,000	7,500	5,700	11,400
Reklame	8,000	8,000	6,000	4,500	4,800
Leje, certificate transporti	2,000	2,000	3,000	2,200	1,500
Autorizim treg. Karburanti lende djegese	9,000	9,000	32,500	10,000	10,000
Ndotjes mjedisit	19,000	19,000	28,500	30,000	42,000
Parkim automjete	40,000	20,000	37,500	30,000	98,728

Tarifa:

- **Emblemë bashkie** për vitin 2026 parashikohet të jetë **68 mijë lekë**.
- **Uji pijshëm** për vitin 2026 parashikohet të jetë **20 mijë lekë**.
- **Shërbimi karrotresh** për vitin 2026 parashikohet të jetë **300 mijë lekë**.
- **Lëshimin e dok.nga arkiva** për vitin 2026 parashikohet të jetë **100 mijë lekë**.
- **Rrjetin e tubacion ujrave zeza** për vitin 2026 parashikohet të jetë **300 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Embleme bashkie	100	60	70	70	68
Uji pijshem	100	30	15	20	20
Sherbimi karrotresh	500	500	500	500	300
Leshimin e dok.nga arkiva	200	200	100	100	100
Rrjetin e tubacion.ujrave zeza	290	290	290	300	300

Tarifa:

- Leje përdorimi për objekte biznesi për vitin 2026 parashikohet 1,500 mijë lekë.
- Hartim PDV për sipërfaqen e pronës për vitin 2026 parashikohet 2,000 mijë lekë.
- Shqyrtim dokumenta leje ndërtimi për vitin 2026 parashikohet 2,900 mijë lekë.
- Kantier ndërtimi për objekt mbi 4 kat për vitin 2026 parashikohet 7,000 mijë lekë.
- Rrjetin e tubacion ujrave bardha për vitin 2026 parashikohet 2,200 mijë lekë.
- Shërbimi për rrjetin kabllor për vitin 2026 parashikohet të jetë 6,000 mijë lekë.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Leje përdorimi për objekte biznesi	2,000	24,500	12,000	1,000	1,500
Hartim PDV për sipërfaqen e pronës	2,000	22,000	13,750	8,000	2,000
Shqyrtim dokumenta leje ndërtimi	3,000	3,000	3,000	1,200	2,900
Kantier ndërtimi për objekt mbi 4 kat	5,500	5,500	5,500	5,000	7,000
Rrjetin e tubacion.ujrave bardha	2,200	2,200	2,200	2,200	2,200
Shërbimi për rrjetin kabllor	4,000	4,000	4,000	3,000	6,000

Tarifa:

- Lëshimin e vërtetimeve për vitin 2026 parashikohet të jetë 2,130 mijë lekë.
- Leje përdorimi për banim për vitin 2026 parashikohet të jetë 2,000 mijë lekë.
- Certifikim relievi për vitin 2026 parashikohet të jetë 2,300 mijë lekë.
- Deklarim paraprak për vitin 2026 parashikohet të jetë 800 mijë lekë.
- Trajt fasadës ndërtesave për vitin 2026 parashikohet të jetë 3,000 mijë lekë.
- Aplikim leje zhvillimi për vitin 2026 parashikohet të jetë 500 mijë lekë.
- Autoriz., zgjatje orari, etj për vitin 2026 parashikohet të jetë 3,700 mijë lekë.

Paraqitja grafike e të dhënave:



Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Leshimin e vertetimeve	2,200	2,283	2,284	2,100	2,130
Leje perdorimi per banim	1,200	2,200	5,750	600	2,000
Certifikim relievi	1,000	1,000	2,300	2,300	2,300
Deklarim paraprak	1,300	4,300	1,500	1,500	800
Trajt.fasades ndertesave	1,200	1,200	2,000	2,000	3,000
Aplikim leje zhvillimi	1,500	1,500	1,000	500	500
Autoriz., zgjatje orari, etj	2,200	2,200	2,200	2,200	3,700

TË ARDHURAT JO-TATIMORE

Për vitin 2026 të ardhurat jo tatimore janë parashikuar në vlerën e **161,968 mijë lekë**.
Një pasqyrim në vija të përgjithshme i parashikimit të të ardhurave për vitet 2022 - 2026, mund të shihet si më poshtë:

Qera objekti për vitin 2026 parashikohet të jetë **450 mijë lekë**.

Qera toke bujqesore për vitin 2026 parashikohet të jetë **310 mijë lekë**.

Gjoba ndertimi për vitin 2026 parashikohet të jetë **50,000 mijë lekë**.


Gjoba biznesi për vitin 2026 parashikohet të jetë **12,000 mijë lekë**.

Te ardhura nga legalizimet për vitin 2026 parashikohet të jetë **45,000 mijë lekë**.

Te ardhura nga shitja e aseteve për vitin 2026 parashikohet të jetë **45,000 mijë lekë**.

Qera trualli (tokë e pa frytshme) për vitin 2026 parashikohet të jetë **4,208 mijë lekë**.

Paraqitja grafike e të dhënave:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Qera objekti	3,000	695	560	500	450
Qera trualli (tokë e pa frytshme)	2,500	4,208	0	120	4,208
Qera toke bujqesore	500	310	310	310	310
Gjoba ndertimi	20,000	12,000	70000	70,000	50,000
Gjoba biznesi	10,000	8,460	9000	10,500	12,000
Gjoba policia bashkiake			1000	1,000	5,000
Te ardhura nga shitja e aseteve (FK)	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000
Te ardhura nga legalizimet	97,000	151,500	50000	50,000	45,000

TE ARDHURAT NGA INSTITUCIONET

Për vitin 2026 të ardhurat nga Institucionet janë parashikuar në vlerën e **80,653 mijë lekë**. Një pasqyrim në vija të përgjithshme i parashikimit të të ardhurave për vitet 2022 - 2026, mund të shihet si më poshtë:

Paraqitja grafike e të dhënave:



Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Cerdhet	9,680	11,616	12003	11,616	14,714
Kopeshtet	34,074	32,718	35042	33,493	35,622
Qerate	8,201	8,201	8209	8,177	8,201
Klubi Shumesporte	1,030	1,030	1246	1,246	1,346
Qendra e Artit	500	900	750	900	1,100
Qendra e Trashegimise Kulturore	100	120	230	300	70
Sherbimet Publike	17,350	10,600	14,250	13,600	12,100
Banesat Sociale me Qira	8,000	8,000	8,000	7,500	7,500

Te ardhura nga Cerddhet për vitin 2026 parashikohet të jetë 14,714 mijë lekë.

Te ardhura nga kopeshtet për vitin 2026 parashikohet të jetë 35,622 mijë lekë.

Te ardhura nga qerate për vitin 2026 parashikohet të jetë 8,201 mijë lekë.

Te ardhura Klubi Shumesporte për vitin 2026 parashikohet të jetë 1,346 mijë lekë.

Qendra e Artit për vitin 2026 parashikohet të jetë 1,100 mijë lekë.


Qendra e Trashegimise Kulturore për vitin 2026 parashikohet të jetë 70 mijë lekë.

Agjensia e Sherbimeve Publike për vitin 2026 parashikohet të jetë 12,100 mijë lekë.

Te ardhura nga Banesat Sociale me Qira për vitin 2026 parashikohet të jetë 7,500 mijë lekë.

TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE

Për vitin 2026 të ardhurat nga funksionet specifike janë parashikuar në vlerën e **75,015 mijë lekë**. Një pasqyrim në vija të përgjithshme i parashikimit të të ardhurave për vitet 2022 - 2026 mund të shihet si më poshtë:



Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Zjarrfikesja	2,300	2,000	2000	2,000	2,200
Sherbimi Pyjor	22,500	45,160	82989	65,200	65,565
Ujitja dhe Kullimi	4,760	5,500	6000	6,000	7,250

Te ardhura nga Zjarrfikesja për vitin 2026 parashikohet të jetë 2,200 mijë lekë.

Te ardhura nga Sherbimi Pyjor për vitin 2026 parashikohet të jetë 65,565 mijë lekë.

Te ardhura Ujitja dhe Kullimi për vitin 2026 parashikohet të jetë 7,200 mijë lekë.


KAPITULLI -3

TRANSFERTAT NGA BUXHETI I SHTETIT

A) Transferta e Pakushtëzuar

Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor.

Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë Elbasan për periudhën 2022 – 2026 paraqitet si vijon:




Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Transferta e pakushtebruar	711,855	839,574	1,009,975	1,147,754	1,239,785

Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026, është në masën **1,239,785 mijë lekë** me një rritje prej rreth 8%, krahasimisht me vitin 2025. Transferta e pakushtëzuar përbën rreth 30% të të ardhurave për vitin 2026.

B) Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Transferta e pakushtëzuar sektoriale në buxhetin e vitit 2026, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara. Këto fonde përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë.

Transferta e kushtëzuar për Bashkinë Elbasan për periudhën 2022 - 2026 paraqitet si vijon:



Te ardhurat nga	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Transferta pakushtezeug sektoriale	472,136	492,603	534,053	655,800	762,129

Transferta e pakushtëzuar sektoriale nga Buxheti i Shtetit për vitin 2026, është në masën **762,129 mijë lekë**, me një rritje prej **16%**, në krahasim me vitin 2025.

Analizë e detajuar e të ardhurave 2025–2026

Të ardhurat totale për vitin 2026 parashikohen në nivelin **4,013,100**, duke shënuar një **rritje afro 6%** krahasuar me vitin 2025 (**3,799,774**). Kjo rritje reflekton një kombinim të zgjerimit të bazës së të ardhurave vendore dhe rritjes së mbështetjes nga transfertat buxhetore.

1. Të ardhurat e trashëguara

Të ardhurat e trashëguara për vitin 2026 paraqesin ulje krahasuar me vitin 2025, duke reflektuar përdorim më të plotë të fondeve gjatë vitit 2025:

- Vlera e trashëguar bie nga 176,390 në 135,227 **(-23%)**,
- ndërsa të ardhurat vendore të trashëguara ulen nga 130,000 në 118,000 **(-9%)**.
- Granti specifik i trashëguar shënon rënien më të madhe, nga 46,390 në 17,226 **(-63%)**, duke treguar përfundimin ose avancimin e projekteve përkatëse.

Çka tregon përdorimin e fondeve të mbetura në vitin pararendës dhe varësi më të ulët nga këto burime në vitin 2026.

2. Të ardhurat vendore

Të ardhurat vendore rriten me **20%**, duke qenë një nga shtyllat kryesore të rritjes së përgjithshme të buxhetit.

- **Të ardhurat nga taksat vendore** rriten me **12%**, ku ndikimin kryesor e japin:
 - **Taksa mbi ndërtesat** (+37%), si rezultat i përmirësimit të administrimit fiskal dhe zgjerimit të bazës tatimore;
 - rritje më të moderuara në taksën mbi truallin (+12%) dhe aktivitetin hotelier (+11%).
 - Në të kundërt, **taksa e ndikimit në infrastrukturë** (-9%) dhe **tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël** (-25%) shfaqin rënie.
- **Të ardhurat nga taksat e ndara** shënojnë rritje prej **13%**, të mbështetura kryesisht nga:
 - **Tatimi mbi të ardhurat personale** (+33%),
 - **Taksa vjetore e mjeteve të përdorura** (+8%). Rënie vërehet në taksën mbi kalimin e së drejtës së pronësisë (-46%).
- **Të ardhurat nga tarifat** përbëjnë zërin me rritjen më të fortë, me **+44%**, ku dallohen:
 - **Parkimi i automjeteve** (+229%),
 - tarifat e pastrimit (+37%), gjelbërimit (+43%), ndriçimit (+52%) dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës (+100%). Kjo tregon një fokus më të madh në mbulimin e kostove të shërbimeve publike përmes tarifave.

3. Të ardhurat jo-tatimore

Të ardhurat jo-tatimore ulen me 9%, kryesisht për shkak të:

- rënies së **gjobave të ndërtimit** (-29%),
- uljes së të ardhurave nga **legalizimet** (-10%),

Megjithatë, disa zëra shfaqin rritje të fortë, si **qiratë e truallit të pafrytshëm** dhe **gjobat nga policia bashkiake**, por në total shfaqet rënie e përgjithshme.

4. Të ardhurat nga institucionet

Të ardhurat institucionale rriten me 5%, të nxitura nga:

- arsimi parashkollor (+10%),
- çerdhet (+27%),
- aktivitetet e teatrit dhe biletave.

Nga ana tjetër, vërehet rënie në të ardhurat nga trashëgimia kulturore, shërbimet rurale dhe disa njësi administrative.

5. Të ardhurat nga funksionet specifike

Këto të ardhura shënojnë një **rritje të lehtë prej 2%**, me rritje në:

- shërbimin zjarrfikës (+10%),
 - tarifat për lëndë drusore (+10%),
 - ujitjen dhe kullimin (+21%),
- ndërsa të ardhurat nga qiratë e pyjeve dhe kullotave shfaqin rënie (-7%).

6. Transferrat nga buxheti i shtetit

- **Transferrat e pakushtëzuara** rriten me 8%, kryesisht për shkak të fondeve për rritjen e nivelit të pagave (+29%).
- **Transferrat specifike** shënojnë një rritje më të lartë prej 16%, ku veçohen:
 - arsimi parashkollor dhe parauniversitar,
 - administrimi i pyjeve,
 - **menaxhimi i mbetjeve urbane** (+195%), që përbën një zë me ndikim të fortë në rritjen e përgjithshme.


KAPITULLI -4

PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2026

Shpenzimet e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, parashikohen të jenë sipas programeve buxhetore si më poshtë:

PROGRAMI		VITI 2026
AA109	Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse	639,382
AB109	Rendi dhe siguria publike	258,474
AC109	Ceshtjet ekonomike dhe bujqësia	683,435
AD109	Mbrojtja e mjedisit	413,772
AE109	Zhvillimi urban dhe shërbimet publike	482,957
AF109	Argetimi, kultura dhe portet	264,657
AG109	Arsimi	880,329
AH109	Mbrojtja sociale	346,495
AI109	Fondi rezerve dhe kontigjenca	43,600
TOTALI		4,013,100

Paraqitja grafike e raporteve të programeve për vitin 2026:




Në vitin 2026 shpenzimet e përgjithshme parashikohet të jenë në masën **4,013,100 mijë lekë** krahasuar me shpenzimet e parashikuara për vitin 2025 të cilat janë **3,799,774 mijë lekë**. Në raport me vitin 2025 shpenzimet e parashikuara janë rritur 6%, dhe në vlerë janë **213,327 mijë lekë**.

1. AA109 – Programi Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse

Ky program përfshin të gjitha funksionet drejtuese, administrative dhe mbështetëse që sigurojnë funksionimin normal të bashkisë. Ai mbulon shpenzimet për organet vendimmarrëse dhe ekzekutive, administratën e bashkisë, planifikimin strategjik, menaxhimin financiar dhe buxhetor, prokurimet publike, shërbimet juridike, arkivën, teknologjinë e informacionit, si dhe shërbimet logjistike. Programi synon rritjen e efikasitetit institucional, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për vitin 2026 parashikohet në masën **639,382 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse	613,650	598,393	627,912	639,382

2. AB109 – Programi Rendi dhe siguria publike

Programi i rendit dhe sigurisë publike synon garantimin e rendit, qetësisë dhe sigurisë në territorin e bashkisë. Ai përfshin veprimtarinë e Policisë Bashkiake, kontrollin e territorit, zbatimin e akteve vendore, parandalimin e kundërvajtjeve administrative dhe mbrojtjen e pasurisë publike. Gjithashtu, programi mbështet bashkëpunimin me institucionet e tjera të rendit dhe strukturat e emergjencave për menaxhimin e situatave të rrezikut.

Për vitin 2026 parashikohet në masën 258,474 mijë lekë.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Rendi dhe siguria publike	187,427	199,990	228,274	258,474

3. AC109 – Programi Çështjet ekonomike dhe bujqësia

Ky program synon zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të territorit të bashkisë dhe mbështetjen e sektorit bujqësor. Ai përfshin politikat për nxitjen e sipërmarrjes vendore, menaxhimin e tregjeve dhe hapësirave tregtare, zhvillimin e infrastrukturës ekonomike, mbështetjen e fermerëve dhe prodhuesve vendas, administrimin e tokës bujqësore, si dhe promovimin e zhvillimit rural dhe agroturizmit.

Për vitin 2026 parashikohet në masën 683,435 mijë lekë.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Cështjet ekonomike dhe bujqësia	859,426	779,286	748,060	683,435

4. AD109 – Programi Mbrojtja e mjedisit

Programi i mbrojtjes së mjedisit përqendrohet në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit jetësor. Ai përfshin menaxhimin e mbetjeve urbane, pastrimin e mjedisit, mbrojtjen e burimeve natyrore, biodiversitetit dhe peizazhit, si dhe zbatimin e politikave për reduktimin e ndotjes. Gjithashtu, programi synon rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor dhe respektimin e standardeve mjedisore.

Për vitin 2026 parashikohet në masën **413,772 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Mbrojtja e mjedisit	291,208	345,170	320,089	413,772

5. AE109 – Programi Zhvillimi urban dhe shërbimet publike

Ky program mbulon planifikimin dhe zhvillimin urban të territorit, si dhe ofrimin e shërbimeve publike bazë. Ai përfshin hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të zhvillimit, mirëmbajtjen e rrugëve dhe infrastrukturës urbane e rurale, ndriçimin publik, gjelbërimin, pastrimin, furnizimin me ujë të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve. Qëllimi kryesor është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe krijimi i një mjedisi urban funksional dhe të qëndrueshëm.

Për vitin 2026 parashikohet në masën **482,957 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Zhvillimi urban dhe sherbimet publike	352,350	442,965	404,392	482,957

6. AF109 – Programi Argëtimi, kultura dhe sporti

Programi synon zhvillimin e jetës kulturore, artistike dhe sportive të komunitetit. Ai përfshin mbështetjen e institucioneve kulturore dhe artistike, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, si dhe zhvillimin e sportit dhe infrastrukturës sportive. Programi kontribuon në forcimin e identitetit lokal dhe në rritjen e përfshirjes sociale. Përmendim të ky program janë planifikuar aktivitete për rininë në lidhje me sportin në vlerë **1700 mijë lekë**, aktivitete kulturore për rininë në vlerë **3200 mijë lekë**.

Për vitin 2026 parashikohet total në masën **264,657 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Argetimi, kultura dhe portet	205,532	247,129	226,440	264,657

7. AG109 – Programi Arsimi

Programi i arsimit përfshin përgjegjësitë e bashkisë në arsimin parashkollor dhe parauniversitar. Ai mbulon ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, sigurimin e kushteve të përshtatshme për procesin mësimor, mbështetjen e shërbimeve ndihmëse, konvikteve dhe aktiviteteve edukative. Synimi është garantimi i aksesit dhe cilësisë së arsimit për të gjithë fëmijët dhe nxënësit.

Për vitin 2026 parashikohet në masën **880,329 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Arsimi	728,625	785,950	923,091	880,329

8. AH109 – Programi Mbrojtja sociale

Ky program ka në fokus mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të shtresave në nevojë. Ai përfshin administrimin e ndihmës ekonomike, shërbimet sociale për familjet në vështirësi, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe programet e strehimit social. Programi synon uljen e varfërisë, rritjen e përfshirjes sociale dhe garantimin e mbështetjes për kategoritë vulnerabël.

Për vitin 2026 parashikohet në masën **346,495 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:




PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Mbrojtja Sociale	154,093	161,867	301,516	346,495

9. AI109 – Programi Fondi rezervë dhe kontigjenca

Programi i fondit rezervë dhe kontigjencës shërben për përballimin e situatave të paparashikuara dhe emergjencave. Ai përdoret për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me fatkeqësi natyrore, emergjenca civile, kriza të papritura dhe nevoja urgjente të bashkisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat buxhetore.

Për vitin 2026 parashikohet në masën **43,600 mijë lekë**.

Paraqitja grafike:



PROGRAMI	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	VITI 2026
Fondi rezerve dhe kontigjenca	20,000	29,000	20,000	43,600

KAPITULLI -5

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK

Ndarja e Shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

Ndarja e shpenzimeve për vitin 2026 sipas karakterit ekonomik paraqitet si më poshte ku përkatesisht shpenzimet e personelit parashikohen në masën 1,829,628 mijë lekë, shpenzimet operative dhe të tjera parashikohen në masën 1,331,338 mijë lekë dhe shpenzimet kapitale/investime në masën 852,134 mijë lekë.


Klasifikimi Ekonomik	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Shpenzime personeli	1,357,414	1,689,267	1,829,628
Shpenzime te tjera operative	1,246,702	1,211,170	1,331,338
Shpenzime kapitale	985,634	899,337	852,134
Totali	3,589,750	3,799,774	4,013,100

Shpenzimet e personelit për vitin 2026 parashikohet në masën 46%.

Shpenzimet e tjera operative për vitin 2026 parashikohet në masën 33%.


Shpenzimet kapitale/investime për vitin 2026 parashikohet në masën 21% .

Paraqitja grafike e parashikimit të shpenzimeve të vitit 2026:



Dr. Buxhetit dhe
Finances Përgj.

Manuela Beluli




Dr. Buxhetit dhe
Finacës

Alketa Merkja




Dr. Taksave Tarifave
Vendore

Klevis Çullhaj



Dr. Agjensisë së
Shërbimeve Publike

Edvin Palloshi



Dr. Planifikimit
Territorit dhe Projekteve


Klajdi Haxhihyseni

Dr. Juridike:
Arben Hoxha

Drejtor i SHMZSH
Emirjan Sota




Dr. Përgj:
Altin Cenolli




Dr. Përgj:
Servo Mehmeti



Dr. Përgj:
Dorina Rroseni



Zv/kryetar:
Armand Shehu



Zv /kryetar:
Asim Sula



Miratoi

Zv/kryetar:
Klaudia Krasnika





**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot.

Datë ____ .12. 2025

P/VENDIM

NR. _____ , DATË ____ . 12. 2025

MBI

**“Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit
Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.12/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, pasi mori në shqyrtim materialet “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028”, të përgatitur nga Bashkia e Qytetit Elbasan nëpërmjet drejtorive të saj, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan,

VENDOSI

1. Të miratojë buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë dhe institucionet vartëse të saj, në nivel programi, si më poshtë dhe sipas pasqyrave e materialeve bashkëlidhur :

1. Të ardhura gjithsej: 4,013,100 mijë lekë

2. Shpenzime gjithsej : 4,013,100 mijë lekë

2. Të miratojë kërkesat për projektet e investimeve për vitin 2026, me fondet e Zhvillimit të Rajoneve, sipas pasqyrës bashkëngjitur.

